



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË
MINISTRATVE NR. 177, DATË 6.3.2012 "PËR AMBALAZHET DHE MBETJET E
TYRE"*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", me propozimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në Kreun I, pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

"1. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit dhe shëndetit publik përmes: parandalimit të ndikimit negativ nga ambalazhet dhe mbetjet e tyre, parandalimit të prodhimit të mbetjeve nga ambalazhet nepermjet rritjes së ripërdorimit të tyre, riciklimit dhe formave të tjera të rekuperimit të mbetjeve nga ambalazhet, si dhe reduktimit të sasive të këtyre mbetjeve që asgjeshohen përfundimisht."

"2. Vendimi përcakton rregulla për prodhimin dhe importimin e të gjitha llojeve të ambalazheve dhe menaxhimin e mbetjeve të tyre në të gjitha fazat, si dhe të përcaktojë subjektet përgjegjëse për menaxhimin e tyre"

2. Kreu II, ndryshon si më poshtë vijon:

"Ky vendim zbatohet për të gjithë llojet e ambalazheve dhe mbetjet e tyre të hedhura në treg në territorin e Rrepublicës së Shqipërisë, nëse janë të përdorura apo të vendosura në qarkullim në industri, tregti, institucione shtetërore, zyra, dyqane, shërbime, për përdorim familjar, apo çdo fushë tjetër të veprimtarisë njerëzore, pavarësisht nga materiali i përdorur."

* Ky vendim është përafëruar plotësisht me Direktivën 2015/720/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 29 prill 2015 që amendon direktivën 94/62/KE në lidhje me përdorimin e qeseve të lehta plastike mbajtëse. Numri CELEX: 32015L0720, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 115, datë 06. 05. 2015, faqe 11 - 15.

mbajtëse sipas përcaktimeve të këtij vendimi, vetëm pasi sigurohet që në të janë të dukshme:

- inicialet identifikuese të prodhuesit;
- shenjat treguese që përcaktojnë llojin e plastikes që është përdorur për prodhimin e qeses apo ambalazhit;
- shenjen aditivit vetshkatërrues të përdorur;
- datën, muajin, dhe vitin e prodhimit;
- shenjen identifikuese që tregon se qesja është e riciklueshme dhe duhet depozituar dhe mbledhur e ndare nga mbetjet organike;
- shenjen për përdorim në kontakt drejtperdrejt me produktin ushqimor nëse është prodhuar për atë qëllim.

2. Prodhuesi, importuesi, tregtuesi apo çdo subjekt tjetër ekonomik privat apo publik, mban dhe ruan informacion mbi hallkën e mëparshme apo pasuese të qeseve plastike mbajtëse për një periudhë jo më të vogël se 36 muaj, me qëllim identifikimin dhe gjurmimin e procesit të daljes në qarkullim të këtyre qeseve.

3. Informacioni i përmendur në pikën 5 të këtij kreu, i jepet inspektorit të mjedisit apo nëpunësit të agjencisë së mjedisit sipas kërkesës së tij.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Inspektoriatin Kombëtar të Mjedisit, organet doganore e tatimore dhe Inspektoriatin Qëndror Teknik, mbledh dhe administron në mënyrë periodike vjetore informacion mbi sasinë e qeseve plastike mbajtëse të kategorizuara sipas përcaktimeve të kreut XII, të këtij vendimi, në qarkullim në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe sasinë e tyre të përdorur në industrinë ricikluese.”

7. Në Kreun XV, pika 2 ndryshon si më poshtë vijon:

“2. Pas 2 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ndalohet hedhja në treg apo përdorimi në çdo rast i qeseve të lehta plastike mbajtëse.”

8. Në Kreun XV, pika 3 ndryshon si më poshtë vijon:

“3. Pas 2 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ndalohet hedhja në treg apo përdorimi në çdo rast i qeseve plastike mbajtëse të pa biodegradueshme.”

9. Në Kreun XV, pika 4 dhe 5 shfuqizohen

10. Kreun XVI, ndryshon si më poshtë vijon:

“Ngarkohet Ministria, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Qendror Teknik, Inspektorati Kombëtar i Mjedisit, Autoritetet Doganore dhe ato Tatimore, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre, për zbatimin e këtij vendimi.”

RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKTVENDIMIN

"PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 177, DATË 06.03.2012 "PËR AMBALAZHET DHE MBETJET E TYRE"

I. QËLLIMI I PROJEKT VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përdorimi i qeseve plastike me një përdorim (me trashësi nën 35 mikron në çdo anë) është bërë një nga problemet kryesore për mjedisin në Shqipëri. Këto qese mund të përdoren vetëm një herë, dhe për shkak pareteve shumë të holla mbledhja e tyre për qëllime riciklimi nuk ka leverdi ekonomike, duke e bërë këtë aktivitet pa interes, për këtë segment të trajtimit të mbetjeve. Depozitimi i tyre në natyrë bëhet në mënyrë të pakontrolluar duke u kthyer një prej problemeve mjedisore më akute si me pamjen e tyre ashtu edhe me dëmin mjedisor që shkaktojnë.

Duke qenë se nga vitit 2012 kur është miratuar VKM-ja nr. 177, e cila ka transpozuar Direktivën 94/62/EC, BE ka amenduar disa herë këtë direktivë si dhe ka miratuar Direktivën (EU 2015/720), si dhe duke marrë parasysh vullnetin e shprehur në këto akte të BE-së për të reduktuar përdorimin e qeseve të lehta dhe shumë të lehta mbajtëse transportuese, bëhet i domosdoshëm amendimi i VKM-së 177/2012. Amendimi i parashikuar në projekt vendimin e propozuar për miratim, tejkalon masat shtrënguese të vendosura nga BE nëpërmjet Direktivës (EU 2015/720) për shkak se problematika e shkaktuar në mjedis nga këto ambalazhe dhe mbetjet e tyre është disa herë më e madhe se ajo e vlerësuar në territorin e shteteve anëtare të BE-së.

Në vlerësimin e institucionit propozues, gjatë hartimit të këtij projekt vendimi janë marrë në konsideratë praktika të ndryshme të rregullimit ligjor të kësaj problematike në nivel evropian dhe botëror (si psh. Queensland Australi). Me qëllim realizimin e detyrimit ligjor për informim dhe konsultim publik, gjatë hartimit të këtij projekt vendimi janë konsultuar grupet e interesit (si p.sh. Shoqata e Konvertuesve të Plastikës).

Hartimi i këtij projekt vendimi realizohet me qëllim të kontrollit të prodhimit, ndalimit, apo reduktimit të ambalazheve dhe sasive të mbetjeve të ambalazheve, e ndikimeve negative që ato kanë për mjedisin ku ne jetojmë dhe shëndetin e njeriut. Përdorimi i qeseve plastike mbajtëse në ditët e sotme është në nivele të larta, dhe me premisa të mëdha të rritet edhe më shumë nëse nuk merren masat e nevojshme. Mbeturinat e qeseve plastike mbajtëse përveç ndotjes së mjedisit, përkeqësojnë edhe problemin e përhapur të hedhjes së tyre në ujëra duke dëmtuar e çënuar kështu ekosistemin ujor. Për më tepër hedhja apo akumulimi i qeseve plastike mbajtëse në mjedis ka efekt negativ të drejtpërdrejtë edhe në disa aktivitete ekonomike.

Qeset plastike mbajtëse shërbejnë për disa qëllime dhe përdorimi i tyre do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me përjashtim të qeseve të lehta plastike mbajtëse, sipas kuptimit të këtij projekt vendimi, që përdoren vetëm një here, dhe si rrjedhojë përfundojnë si “mbeturinë” në natyrë duke dëmtuar mjedisin. Me qëllim reduktimin e kësaj kategorie të qeseve plastike mbajtëse, do të rritet ri-përdorimi i qeseve të tjera plastike shumë-përdorimshme, të cilat pas dëmtimit, jo vetëm që nuk kthehen në “mbeturinë” në mjedis, por mund të riciklohen nga kompanitë e riciklimit.

Objektivi që synohet të arrihet është rishikimi i dispozitave me qëllim zbatueshmërinë e VKM-së nr. 117, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, pra si rrjedhojë e kontrollit të prodhimit dhe përdorimit nga konsumatorët e qeseve plastike mbajtëse të pa-riciklueshme do të arrihet efekti i pritshëm i përmirësimit të mjedisit të Republikës së Shqipërisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKT VENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projekt vendim është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi cilësinë për ambalazhet të tilla si ato të përdorura për të garantuar sigurinë, mbrojtjen e shëndetit dhe higjienën të produktit të paketuar, apo të kërkesave ligjore mbi transportin e mbetjeve të rrezikshme.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projekt vendim është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës. Ai propozohet në bazë të delegimit të parashikuar në nenin 29 të Ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

Ky projekt vendim është hartuar edhe në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, konkretisht me Direktivën e Bashkimit Evropian 2015/720 “Për ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve”. Duhet të theksohet se ky projekt vendim parashikon masa shtrënguese më tepër se çfarë parashikon Direktiva 2015/720, për arsye se ndotja e mjedisit nga ambalazhet dhe mbetjet e tyre në Republikën e Shqipërisë është me e lartë në krahasim me vendet e Bashkimit Evropian.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT VENDIMIT

Projekt vendimi i propozuar përbëhet nga *njëmbëdhjetë* paragrafë si vijon:

Paragrafi 1, është përcaktuar më qartë qëllimi i projekt vendimit në përputhje edhe me legjislacionin evropian, si dhe janë shtuar instrumente të tjera të domosdoshme për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Ky paragraf gjithashtu

përcakton rregullat lidhur me prodhimin dhe importimin e të gjitha llojeve të ambalazheve, menaxhimin e mbetjeve të tyre në të gjitha fazat, si dhe përcakton subjektet përgjegjëse për menaxhimin e tyre.

Paragrafi 2, përcakton qartësisht fushën e veprimit të projekt vendimit, duke parashikuar se ky vendim do të zbatohet për të gjitha llojet e ambalazheve dhe mbetjeve të tyre, pavarësisht nga arsyeja e përdorimit.

Paragrafi 3, shpjegon termat që do të përdoren në këtë projekt vendim, të tilla si “plastik”, “qese e lehtë plastike mbajtëse” dhe “qese plastike mbajtëse oxo-degradueshme”.

Paragrafi 4, përkufizon më imtësisht termin “qese plastike mbajtëse”, duke përmendur jo vetëm materialin përbërës dhe përdorimin, por edhe formën e saj.

Paragrafi 5, parashikon detyrimin mbi prodhimin e qeseve plastike mbajtëse, që duhet të përfshijë aditivë biodegradues me një cikël veprimi jo më pak se 36 muaj, i cili mundëson realizimin e ciklit të plotë të përdorimit nga prodhimi, magazinimi, tregtimi, përdorimi dhe kthimi për riciklim përpara se ky produkt të ketë humbur vlerat për riciklim.

Paragrafi 6, parashikon detyrimin se prodhuesi ose importuesi, do të hedhë në treg apo të vendosë në qarkullim qeset plastike mbajtëse, vetëm pasi sigurohet që në të është vendosur në mënyrë të dukshme hallka me të gjithë elementët e përmendur në këtë paragraf si dhe duhet të ruajë këtë informacion për një periudhë jo më të vogël se 36 muaj, me qëllim identifikimin dhe gjurmimin e procesit të daljes në qarkullim të këtyre qeseve. Nëpërmjet këtij detyrimi organet përgjegjëse të përmendur në këtë paragraf, mbledhin dhe administrojnë në mënyrë periodike vjetore informacion mbi sasinë e qeseve plastike në qarkullim në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe sasinë e tyre të përdorur në industrinë ricikluese.

Paragrafi 7, parashikon ndalimin e hedhjes në treg apo përdorimit të qeseve të lehta plastike mbajtëse, sipas përkufizimit të dhënë në këtë projekt vendim, pas një afati tranzitor prej 2 muajsh.

Paragrafi 8, parashikon ndalimin e hedhjes në treg apo përdorimit të qeseve plastike mbajtëse të pa biodegradueshme, sipas përkufizimit të dhënë në këtë projekt vendim, pas një afati tranzitor prej 2 muajsh.

Paragrafi 9, parashikon shfuqizimin e pikave 4 dhe 5, të kreut XV, të VKM-së nr. 117, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.

Paragrafi 10, përcakton institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e këtij projekt vendimi, i cili përfshin jo vetëm Ministrinë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit,

Inspektoratin Qendror Teknik, Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit, njësitë e vetë-qeverisjes vendore, por edhe autoritetet doganore dhe ato tatimore.

Paragrafi 11, parashikon sanksionet në rast të shkeljes së detyrimit sipas paragrafëve të këtij projekt vendimi, të cilat do të ndëshkohen sipas përcaktimit të nenin 62, pika 24 të Ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROHEKT VENDIMIT

Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohen:

1. Ministria Turizmit dhe Mjedisit;
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
3. Inspektorati Kombëtar i Mjedisit;
4. Inspektorati Qendror Teknik;
5. Njësitë e vetë-qeverisjes vendore – entet e varësisë;
6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
7. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.


VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT VENDIMIT

Për hartimin e këtij projekt vendimi, përveç strukturave në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, kanë kontribuar:

Ekspertë të projektit: GIZ project “Climate-friendly, Integrated Waste and Recycling Management”

Shoqata e Konvertuesve të Plastikës;

Organizata Jo-fitimprurëse;


MINISTRI
BLENDI KLOSI

Direktiva 2015/720, Neni 1, pika 1/a	higjienës së produkteve të paketuara ose të kërkesave ekzistuese të transportit ose në përputhje me dispozitat e Direktivës së Këshillit 91/689 / Dhjetor 1991 mbi mbeturinat e rrezikshme (2).	"plastikë" nënkupton një polimer brenda kuptimit të nenet 3(5) të rregullores (EC) No 1907/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*), në të cilën shitesit apo substancat e tjera janë shtuar dhe që mund të funksionojë si një komponent strukturor kryesor i qeseve mbajtëse;	Paragrafi 3, pika 25/a – "plastik"	ndesh me kërkesat e legjislationit në fuqi mbi cilësinë për ambalazhet të tilla si ato të përdorura për të garantuar sigurinë, mbrojtjen e shëndetit publik dhe higjienës të produktit të pakëtuar, apo të kërkesave ligjore mbi transportin e mbetjeve të rrezikshme"	
Direktiva 2015/720, Neni 1, pika 1/c	Qese plastike me peshë të lehtë" do të thotë çanta plastike mbajtëse me trashësi muri nën 50 mikronë;	Paragrafi 3, pika 29/a – "qese e lehtë plastike mbajtëse"	"25/a. "Plastikë" është një polimer të cilin mund t'i jenë shtuar aditivë apo substanca nga lëndë të tjera, si dhe është i aftë të kryejë funksionin kryesorë, lidhes të komponentit strukturorë të një qeseje mbajtëse."	I plotë	
Direktiva 2015/720, Neni 1, pika 1/e	Thasët e çimentos plastike të degradueshme" do të thotë çanta prej plastike të prodhuara prej materialeve plastike që përfshijnë aditivët që katalizojnë fragmentimin e materialit plastik në fragmente mikro,	Paragrafi 3, pika 29/b – "qese plastike mbajtëse oxo-degradueshme"	"29/a. "Qese e lehtë plastike mbajtëse" është qesja plastike me trashësi për çdo anë, me të vogël se 35 mikron, me përjashtim të qeses së përdorur vetëm për qëllime higjieno-sanitare."	I plotë	
			"29/b". "Qese plastike mbajtëse oxo-degradueshme" është qesja plastike mbajtëse e prodhuar nga materiale që përfshijnë aditivë të cilët katalizojnë copëzimin e materialit plastik në mikro-fragmente."	I plotë	

Tabela e Përputhshmërisë e Projekt Vendimit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"

Legjislacioni shqiptar i propozuar: Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre".

Shkalla e përfatimit: e pjesësme.

1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Direktiva 94/62/EC, Neni 1- Objektivat	Kjo direktivë synon të harmonizojë masat kombëtare në lidhje me menaxhimin e mbetjeve nga ambalazhet në mënyrë që, nga njëra anë, të parandalojë çdo ndikim të tyre në mjedisin e të gjitha shteteve anëtare si dhe të vendeve të treta ose të zvogëlojë këtë ndikim, duke siguruar kështu një nivelin e lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe, nga ana tjetër, për të siguruar funksionimin e tregut të brendshëm dhe për të shmangur pengesat për tregtinë, shitëmbërimin dhe kufizimin e		Paragrafi 1, pika 1	1. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit dhe shëndetit publik përmes: parandalimit të ndikimit negativ nga mbetjeve dhe mbetjet e tyre, parandalimit të prodhimit të mbetjeve nga ambalazhet nepernjet rritjes se ripërdorimit të tyre, riciklimit dhe formave të tjera të recuperimit të mbetjeve nga ambalazhet, si dhe reduktimit të sasive të këtyre mbetjeve që asgjësohen përfundimisht."	I plotë	

			Paragrafi 5 - pika 4	nga riciklimi, ose lëndë të paktë ndihmëse alternative jo plastike.		
			4. Prodhuesi i geseve plastike mbajtëse sipas përcaktimeve të pikës 2 dhe 3 të kësaj ndarje, ruan, administron dhe jep informacionin që verëton respektimin e përcaktimeve të kësaj ndarje, sipas kërkesave të përcaktuara në ndarjen VIII të këtij vendimi.	I pazbatueshëm		
			Paragrafi 6 - pika 1, 2, 3, dhe 4	<p>"1. Prodhuesi ose importuesi lejohet të hedhë në treg apo vendosë në qarkullim, gese plastike mbajtëse sipas përcaktimeve të këtij vendimi, vetëm pasi sigurohet që në të janë të dukshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • inicialet identifikuese të prodhuesit; • shenjat treguese që përcaktojnë llojin e plastikës që është përdorur për prodhimin e geseve apo ambalazhit; • shenjat aktivitet veshkatues të përdorur; • datën, muajin, dhe vitin e prodhimit; • shenjat identifikuese që 	I pazbatueshëm	

<p>Direktiva 2015/720, Neni 1, paragrafi 2a dhe 2b</p>	<p>Masat e marra nga Shtetet Anetare do të përshihin njëzën ose të dyja nga të mëposhmet: (a) miratimi i masave që sigurojnë që niveli vjetor i konsumit të mos kalojë 90 çanta plastike të lehta për person deri më 31 dhjetor 2019 dhe 40 qese plastike të lehta për person në 31 Dhjetor 2025, ose objektiva ekuivalente të vendosur në peshe. Çanta plastike shumë të lehta mund të përfshihen nga objektivat e konsumit kombëtar; (b) miratimin e instrumenteve që sigurojnë që deri më 31 dhjetor 2018, qeset e lehta plastike të transportit nuk ofrohen pa pagesë në pikën e shitjes së mallrave ose produkteve, përveç nëse janë zbatuar</p>						
		<p>Paragrafi 7</p>					
			<p>"2. Pas 2 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ndalohet hedhja në treg apo përdorimi në çdo rasi i qesëve të lehta plastike mbajtëse."</p>				<p>tatimore dhe Inspektoriatin Qendror Teknik, mbledh dhe administrojnë në mënyrë periodike vjetore informacionin e dërguar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi sasinë e qesëve plastike mbajtëse të kategorizuara sipas përcaktimeve të ndarjes XII, të këtij vendimi, në qarkullim në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe sasinë e tyre të përdorur në industrinë rrethuese."</p>

		Paragrafi 10	<p>"Nga Kohet Ministria, Agjencia Kombëtare e Mjedist, Inspektorati Qendror Teknik, Inspektorati Kombëtar i Mjedisit, Autoriteti Doganor dhe ato Talmorë, Njësitë e Vetë-qeverisjes Vendore, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre, për zbatimin e këtij vendimi."</p>	I pababueshëm	
		Paragrafi 11	<p>1. Ndarja XVII, ndryshon si më poshtë vijon:</p> <p>"Shkelja e detyrimit sipas përcaktimit të: pikës 2 të ndarjes IV; pikës 1, 2 dhe 3 të ndarjes V; pikës 1 të ndarjes VI; pikës 1 të ndarjes VII; ndarjes VIII; pikës 1 dhe 2 të ndarjes IX; pikës 1 të ndarjes X; ndarjes XI; pikës 1 të ndarjes XII; dhe ndarjes XV, ndeshkohen sipas përcaktimit të nenin 62, pika 25 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar.</p>	I pababueshëm	

	<p>protection, and on the other hand, to ensure the functioning of the internal market and to avoid obstacles to trade and distortion and restriction of competition within the Community.</p>		<p>2. To this end this Directive lays down measures aimed, as a first priority, at preventing the production of packaging waste and, as additional fundamental principles, at reusing packaging, at recycling and other forms of recovering packaging waste and, hence, at reducing the final disposal of such waste.</p>	<p>Paragraph 1, point 2</p>	<p>"2. The decision establishes rules for the production and importation of all types of packaging and waste management at all stages, as well as to determine the entities responsible for their management "</p>	<p>Non compliant</p>	
--	--	--	---	-----------------------------	--	----------------------	--

	of the Council (1) to which additives or other substances may have been added, and which is capable of functioning as a main structural component of carrier bags;			component of a carrying bag "		
Directive 2015/720, Article 1, point 1/c	"lightweight plastic carrier bags" shall mean plastic carrier bags with a wall thickness below 50 microns;	Paragraph 3, point 29/a - "lightweight plastic carrier bags"	"29/a. "lightweight plastic carrier bags" is a plastic bag with a thickness of less than 35 microns, except for a bag used only for sanitation purposes. "	Fully		
Directive 2015/720, Article 1, point 1/e	Thasë e çimentos plastike të degradueshme" do të prodhuara prej materialeve plastike që përfshijnë aditivë që katalizojnë fragmentimin e materialit plastik në fragmente mikro;	Paragraph 3, point 29/b - "oxo-degradable plastic carrier bags"	"29/b". "Qese plastike mbajtëse oxo-degradueshme" është qesia plastike mbajtëse e prodhuar nga materiale që përfshijnë aditivë të cilët katalizojnë copëzimin e materialit plastik në mikro-fragmente."	Fully		
Directive 2015/720, Article 1, point 1/b	"plastic carrier bags" shall mean carrier bags, with or without handle, made of plastic, which are supplied to consumers at the point of sale of goods or products;	Paragraph 4 - "plastic carrier bags"	"Plastic carrier bag "is a carrying bag, with or without a handle made of plastic, and other related materials, provided at the points of sale or distribution of goods or products. "	Fully		
		Paragraph 5 - point 2	"2. Without prejudice to the other specific requirements of this decision, the production of plastic carrying bags according to the definitions of this decision is made using biodegradable additives with a cycle of not less than 36 months, which enables the complete cycle of use from production, storage, trading,	Non compliant		

				<ul style="list-style-type: none"> • date, month, and year of production; • Identification mark showing that the bag is recyclable and should be stored and collected and separated from organic waste; • the mark for use in direct contact with the food product if it is produced for that purpose. 		
			<p>2. The manufacturer, importer, trader or any other private or public economic entity retains and retains information on the previous or subsequent link of plastic hold bags for a period of not less than 36 months in order to identify and trace the exit process in circulation of these bags.</p>			
			<p>3. The information referred to in paragraph 1 of this section shall be given to the environmental inspector or the staff of the environmental agency upon his written request.</p>			
			<p>4. The National Environmental Agency, in cooperation with the National Environmental Inspectorate, the customs and tax authorities and the Central Technical Inspectorate, collects and administers annually the information submitted by the local self-government units on the amount of plastic holding bags categorized according to the separation definitions XII of this Decision, in circulation in the territory of the Republic of Albania, and their quantity used in the recycling industry.</p>			

	<p>objectives:</p> <p>(b) the adoption of instruments ensuring that, by 31 December 2018, lightweight plastic carrier bags are not provided free of charge at the point of sale of goods or products, unless equally effective instruments are implemented. Very lightweight plastic carrier bags may be excluded from those measures.</p>					
<p>Directive 2015/720, Article 1, paragraph 2a and 2b</p>	<p>The measures taken by Member States shall include either or both of the following:</p> <p>(a) the adoption of measures ensuring that the annual</p>		<p>Paragraph 8</p>	<p>"3. After 2 months from the entry into force of this decision, it is prohibited to market or use in any case non-biodegradable plastic bags. "</p>	<p>Fully</p>	

								of sale of goods or products, unless equally effective instruments are implemented. Very lightweight plastic carrier bags may be excluded from those measures.		
						Paragraph 9	Paragraph 9	Points 4 and 5 are repealed.	Non compliant	
						Paragraph 10	Paragraph 10	"The Ministry, the National Environmental Agency, the Central Technical Inspectorate, the National Environmental Inspectorate, the Customs and Tax Authorities, the Local Self-Government Units shall be charged in accordance with the legal obligations deriving from the legislation in force governing the scope of their activity, for the implementation of this decision."	Non compliant	
						Paragraph 11	Paragraph 11	1. Division XVII, changes as follows: "Breach of the obligation according to the definition of point 2 of division IV, points 1, 2 and 3 of division V, point 1, of division VI, point 1 of division VII, division VIII, points 1 and 2 of division IX, point 1 of division X, division	Non compliant	